



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 64/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Fitim R. Bilalli B.I, me seli në Prishtinë, Rr. “Shefqet Shkupi”, p.n, me numër të biznesit 810207599, të cilin e përfaqëson me autorizim Shoqëria e Avokatëve “Pro Juris” me seli në Prishtinë, kundër të paditurve Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, rr. “Migjeni”, dhe Agjencia për Menaxhim Emergjent me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr.665/22, të datës 10.01.2023 i nxjerrë nga OSHP dhe kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, jashtë seancës, më datë 27.02.2023 merr këtë:


A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit Fitim R. Bilalli B.I, me seli në Prishtinë, Rr. “Shefqet Shkupi”, p.n, me të cilin ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të PSH.nr.665/22, të datës 10.01.2023, të nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, deri në vendosjen meritore për çështjen kryesore.

A r s y e t i m

Paditësi Fitim R. Bilalli B.I, me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit PSH.nr.665/22, të datës 10.01.2023, i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të tij, deri në vendosjen meritore për çështjen kryesore.

Paditësi, në kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kryesisht ka përsëritur pretendimet e paraqitura në padi lidhur me ligjshmërinë e aktit kontestues, ndërsa lidhur me plotësimin e kushteve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit ka theksuar se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk e dëmton interesin publik, ndërsa ekzekutimi i tij i sjell dëm të pariparueshëm paditësit sepse normalisht paditësi do të duhej të shpallej fitues, dhe po që se aprovohet padia e paditësit dhe lënda do të fitohet nga paditësi, atëherë buxheti i



Kosovës do të dëmtohej për dy arsye dhe atë sepse është rekomanduar për kontratë një operatorë ekonomik i cili përveç se është i papërgjegjshëm, po ashtu ka ofertuar me çmim më të shtrenjtë se paditësi në vlerën 79,756.00 €, ndërsa e dyta nëse aprovohet kërkesëpadia, atëherë e paditura e dytë do të detyrohet të na kompensojë dëmin e shkaktuar, fitimin e humbur dhe të gjitha shpenzimet tjera në lidhje me këtë projekt. Prandaj, duke u bazuar në nenin 22 par 6 lidhur me par 2 të LKA-së, duke parë që ekzekutimi i vendimit të kontestuar paditësit do ti sillte dëm të pa riparueshëm, dhe duke parë se shtyrja e ekzekutimit të tij nuk është në kundërshtim me interesin publik, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesa e paditësit, dhe të shtyhet ekzekutimi i vendimit PSH.nr.665/22, të datës 10.01.2023, deri në vendosjen meritorë për çështjen kryesore.

Me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, gjykata ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *“Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*. Po ashtu, në paragrafin 6 përcaktohet se *“Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”*.

Bazuar në nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e paditësit të paraqitura në propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që pretendimet e paditësit të paraqitura në kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit nuk kanë mbështetje ligjore, ashtu që nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Gjykata vlerëson se paditësi pretendimet e paraqitura në propozim nuk i ka mbështetur në asnjë provë materiale dhe nuk ka propozuar asnjë provë me të cilat do të vërtetohej se cili është dëmi



konkret dhe si është i matshëm ky dëm që i shkaktohet paditësit, dhe i cili dëm vështirë do të riparohet, ashtu që nuk e ka bërë të besueshme kërkesën e tij mbi ndonjë bazë reale se ekzekutimi i vendimit paditësit do ti sillte ndonjë dëm vështirë të riparueshëm. Gjykata vlerëson se dëmi i cili pretendohet nga paditësi është dëm material i cili nuk është vështirë i riparueshëm duke marrë për bazë që si i padituri është institucion shtetëror dhe në rast të caktimit të dëmit nga gjykata i njëjti mund të realizohet pa vështirësi.

Gjykata po ashtu i vlerësoi si të pabazuara edhe pretendimet e paditësit se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, pasi që gjykata vlerëson se në këtë rast me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit do të pezullohej aktiviteti i prokurimit “Furnizim me Aparate të Frymëmarrjes dhe Bombola të Ajrit”, deri në vendosjen meritore për çështjen kryesore, ashtu që do ti pamundësonte autoritetit kontraktues që të vazhdojë tutje lidhur me aktivitetin e lartcekur, veprim ky që do ishte në kundërshtim me interesin publik.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet tjera të paditësit se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nuk do ti sillte dëm të madh palës kundërshtare, por duke qenë se për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së, në mënyrë kumulative dhe duke qenë se nuk janë plotësuar kushtet se ekzekutimi i vendimit do ti sillte paditësit, dëm vështirë të riparueshëm dhe shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, gjykata e vlerësoi si të panevojshëm trajtimin më tej të kushtit të tretë, përkatësisht nëse kundërshtarit ose palës së interesuar i shkaktohet dëm.

Prandaj, gjykata në këtë rast vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, ndërsa lidhur me pretendimet tjera të paraqitura në padi, gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave të propozuara dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë, por që këto pretendime dhe prova nuk janë me ndikim me rastin e vlerësimit të besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 22 par. 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë



Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.64/23, datë 27.02.2023

Gjyqtari

Arnis Duhani



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.